



UNIVERSITETI I MITROVICËS 'ISA BOLETINI'

Modeli i Programit mësimor të lëndës (Syllabusi)

Fakulteti:	Ekonomik	
Departamenti:	Biznes dhe menaxhment	
Specializimi:	Menaxhment dhe Ndërmarrësi	
Niveli:	Bachelor	
Kodi i lëndës:		
Lënda:	Menaxhimi i operacioneve	
Statusi i lëndës:	Obligative	(Obligative apo zgjedhore)
Semestri:	IV	(Dimëror / Veror)
Fondi i orëve:	2+1	(Sipas programit të aprovuar)
ECTS:	6 ECTS	(Sipas programit të aprovuar)
Orari/Salla		
Viti akademik:	2022/2023	
Mësimdhënës/e:	Prof. Asoc. Dr. Ajtene Avdullahi	
Asistent/e:		
Kontaktet:	Mësimdhënës/e	Asistent/e
Email:	ajtene.avdullahi@umib.net	
Telefon:	+383 45 403200	

PERMB AJTJE	Menaxhimi i operacioneve përqendrohet në bashkëveprimin midis burimeve të operacioneve dhe kërkesave të tregut. Mënyra se si organizatat menaxhojnë burimet e operacioneve është thelbësore për suksesin e tyre afatgjatë. Lënda Menaxhimi i operacioneve synon ofrimin e njohurive bazike studentëve në lidhje me çështjet teorike, praktike dhe shkencore të operacioneve të nevojshme dhe të domosdoshme për menaxhimin efikas të funksionit planifikimit, organizimit, drejtimin dhe kontrollit të burimeve të një biznesi që nevojiten për të prodhuar produkte dhe shërbime me qëllim të realizimit të përfitimeve sa më të mëdha. Gjatë këtij semestri, fenomeni i Menaxhimit të operacioneve do të vlerësohet, të shqyrtohet, kritikohet dhe avancohet. Ky modul bazohet në konceptet e menaxhimit strategjik, operacioneve, marketingut dhe burimeve njerëzore dhe ofron ide shumë të qarta mbi zhvillimin dhe zbatimin e strategjisë së operacioneve për një larmi biznesesh me qëllim të krijimit të avantazhit konkurrues në treg. Moduli përmban tema në lidhje me performancën e operacioneve, kapacitetin, teknologjinë e prodhimit, integrimin vertikal, furnizimin. Në veçanti lënda fokusohet në zhvillimin e produktit/shërbimit si dhe përmirësimin e operacioneve, formulimi, implementimin e operacioneve, monitorimin dhe kontrollin. Moduli ilustron vendimet kryesore me të cilat përballen menaxherët e operacioneve në lidhje me projektimin e operacioneve, menaxhimin e Operacioneve dhe metodat sasiore në lidhje me parashikimin dhe vendimmarrjen.
------------------------	---

QËLLIM I	Çfarë synohet që të arrihet përmes kësaj lënde? Lënda ka për qëllim të pajisë studentët me njohuri në lidhje me rolin vital të Menaxhimit të operacioneve si në ndërmarrjet prodhuese, poashtu edhe ato që ofrojnë shërbime, në ekonominë globale të shekullit të 21. Lënda synon të sigurojë te studentët një themel të fortë në lidhje me teknikat e dizajnit dhe menaxhimit të operacioneve, rolin e operacioneve në ndërtimin e forcës konkurruese të firmës dhe në përmbushjen e qëllimit të firmës për të krijuar vlerë dhe përmbushjen e nevojave dhe kënaqësisë së klientit. Kjo përfshin përshtatjen e aftësive operative të firmës, aktiveve dhe proceseve në një strategji specifike biznesi. Për më tepër, kjo lëndë synon të aftësojë studentët të organizojnë burime operacionesh për zhvillimin e produkteve dhe shërbimeve për lloje të ndryshme të ndërmarrjeve. Në këtë lëndë bëhet ndërthurja e teorisë me praktikën.	
ARRITSHMËRI A	Deri në fund të modulit, studentët duhet të jenë në gjendje: ▪ Të kuptoj rëndësinë dhe kontributin e operacioneve në performancën organizative, ▪ Të përshkruaj ndërlidhjen ndërmjet dizajnit të proceseve dhe operacioneve, strategjisë së ndërmarrjes dhe globalizimit, ▪ Të zbatoj modelet MRP dhe ERP në menaxhimin e operacioneve, ▪ Të adaptoj përkrahjet dhe transformimet që sjell Revolucioni i Katërt Industrial (Industria 4.0) në menaxhimin e operacioneve, ▪ Të analizoj dhe identifikoj shkaqet e humbjeve: muda, mura dhe muri, ▪ Të vlerësoj mjetet dhe teknikat e aplikueshme në kontekstin e operacioneve në dinamikën globale organizatave dhe ▪ Të organizoj rolin e metodologjive kualitative në filozofinë e përmirësimit të vazhdueshëm të operacioneve si TQM, lean, six sigma etj.	
PROGRAMI	Javët	Tema
	Java - I	Njohja me lëndën dhe prezantimi i syllabusit
	Java - II	Strategjia e Operacioneve & Prioritetet Konkurruese
	Java - III	Prioritetet Konkurruese
	Java - IV	Projektimi i Produktit dhe i Shërbimit
	Java - V	Projektimi i Procesit të Prodhimit dhe Shërbimit
	Java - VI	Parashikimi i Kërkesës
	Java - VII	Testi i parë
	Java - VIII	Menaxhimi dhe planifikimi i kapacitetit
	Java - IX	Menaxhimi total i cilësisë
	Java - X	Menaxhimi i zinxhirit të furnizimit
	Java - XI	Planifikimi i burimeve të ndërmarrjes (ERP) planifikimi i kërkesës për materiale (MRP)
	Java - XII	Prezantimi i punimeve seminarike, hulumtimeve grupore
	Java - XIII	Përmirësimi i operacioneve

	Java - XIV	Planifikimi dhe kontrolli i projektit
	Java - XV	Testi i dytë
LITERATURA	Literatura bazë: 1. Suzana Panariti (2015). Strategjia e Operacioneve, Botuesi Joer Shpk, Tiranë -2015. 2. Slack, N., Brandon-Jones, A. (2018). Essentials of Operations Management, 2nd Edition, London, Pearson. Literaturë shtesë: 1. Nigel Slack, Michael Lewis (2011). Operations strategy, 3rd edition. 2. Arthur A, Margaret A. Peteraf, John E. Gamble, A.J. Strickland (2016). Crafting and Executing Strategy: The Quest for Competitive Advantage: Concepts and Cases, Thompson, III, McGraw-Hill Higher Education, 2016 New York. 3. JA Van Mieghem (2008). Textbook Operations Strategy: Principles and Practice by. Publisher: Dynamic Ideas, Charlestown, MA. 2008.	

METOD OLOGJI A E MËSIM DHËNJË S	Metodologjia e mësimdhënies: Do të përfshijë leksione dhe ushtrime (raste studimore, detyra dhe seminare gjatë ushtrimeve). Çdo orë do të përbëhet nga një kombinim i ligjëratave të shkurtra, ushtrimeve dhe detyrave, studimeve të rasteve, diskutimeve në grupe të vogla dhe / ose filma dhe dokumentarë, në varësi të materialit në dispozicion. Studentët inkurajohen të ndjekin zhvillimet aktuale të menaxhimit të operacioneve, duke lexuar artikuj relevantë, dokumentarë, gazeta ekonomike dhe materiale të tjera. Ata mund të identifikojnë çështjet / temat për diskutime nga këto lexime. Më pas diskutohen esetë e përgatitura nga studentët. Duke pasur parasysh se pjesëmarrja e studentëve në diskutime është e rëndësishë të veçantë, ata inkurajohen të diskutojnë duke u rikujtuar atyre se nuk ka përgjigje "të drejtë" ose "të gabuar" kur diskutojnë temat. Në pjesën më të madhe të kohës, çështjet duhet të diskutohen dhe të ballafaqohen dhe nuk kanë zgjidhje të thjeshta dhe të menjëhershme. E rëndësishme është që ata të mendojnë dhe të tentojnë të gjejnë zgjidhje për çështjet dhe temat e trajtuara. Studentët do të ndahen në grupe pune. Ata do të kenë detyra individuale dhe një detyrë në grup. Ata do të prezantojnë punimet e tyre individuale si dhe ato ekipore, e gjithashtu do të vlerësojnë dhe kritikojnë njëri tjetrin. Gjatë kursit do të organizohet vizitë e ndonjë ndërmarrje. Sipas mundësisë, do të ftohen në ligjërata edhe menaxher të suksesshëm të operacioneve si guest speaker, të cilët do të ndajnë përvojat e tyre me studentë. Raporti midis pjesës teorike dhe praktike të studimit Teorikisht, do të sigurohet njohuri e përgjithshme shkencore e bazuar në literaturën bashkëkohore. Pjesa praktike do të realizohet kryesisht përmes shembujve konkretë nga literatura dhe njohuritë praktike të ndërmarrjeve private dhe publike të prodhimit dhe organizatave fitimprurëse. Marrëdhënia midis pjesës teorike dhe asaj praktike jepet në pjesën tabelare të programit të studimit. Raporti teori-praktike: 60% teori dhe 40% praktikë / studim rasti / punim seminarik. Mjetet e mësimdhënies / mjetet IT Mësimdhënia do të zhvillohet në klasë dhe laboratorë përmes ligjeratave, detyrave praktike, interpretimeve individuale dhe grupore, vetëvlerësimeve periodike, etj. Të gjitha këto do të realizohen në teori dhe në praktikë duke paraqitur materialet në formë audiovizuale duke përdorur ligjeratat online. Raporti midis pjesës teorike dhe praktike të studimit Teorikisht, do të sigurohen njohuri të përgjithshme shkencore të bazuara në literaturën më bashkëkohore. Pjesa praktike do të realizohet kryesisht përmes shembujve konkret nga literatura (studimet e rastit) dhe njohuritë praktike të ndërmarrjeve të prodhimit privat dhe publik dhe organizatave fitimprurëse. Marrëdhënia midis pjesës teorike dhe asaj praktike është dhënë në pjesën tabelare të programit të studimit. Raporti teori-praktik: 60% teori dhe 40% praktikë / studim rasti / punim seminarik.
--	--

	Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit - 1 ECTS kredi = 25 orë)			
	Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
	Ligjërata	2	15	30
	Ushtrime teorike/laboratorike	1	15	15
	Ushtrime në terren	1	15	15
	Punë praktike	1	15	15
	Konsultime me mësimdhënësin/asistenten	2	12	24
	Kolokiume /seminare	1	2	2
	Detyra të pavarura	1	15	15
	Koha e studimit vetanëk të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	15	15
	Përgatitja përfundimtare për provim	1	12	12
	Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	1	8	8
	Projektet, prezantimet , etj	1	5	5
	Total			156
VLERËSIMI	Metodat e vlerësimit			
	[sipas Statutit dhe Rregullores për studime të UMIB-it]			
	Testet/Kollokviumet	2*20%=40%		
	Test praktik gjatë ushtrimeve	10%		
	Punim seminarik	10%		
	Interpretimi dhe prezentimi i punimit seminarik	10%		
	Detyrat dhe kurset gjatë semestrit	10%		
	Provimi final	20%		

POLITI KAT AKADE MIKE	Udhëzime të mëtejme : ● Puna me kompjuter Punimet me shkrim duhet doemos të jenë të shkruara me kompjuter. Në punime janë të obligueshme respektimi i kriterëve qoftë për aspektin vizual ashtu edhe përmbajtjesor të punimeve të kërkuara. Gjatë punimeve kërkohet që të respektohen rregullat drejtshkrimore dhe stili APA ● Etika në mësim Punimet e ndryshme semestrale duhet të jenë punime të secilit student. Nuk do të ketë tolerancë për kopjime, “huazime” nga interneti apo çfarëdo materiali tjetër. Punimet e njëjta apo të ngjashme do të kenë vlerësime negative në vlerësimin përfundimtar të studentit. ● Afatet Në marrëveshje me studentët do të përcaktohen afatet e dorëzimit të punimeve. Nuk do të ketë tolerancë për vonesë në dorëzimin e punimeve. Mosardhja në orën kur është shpjeguar detyra nuk e arsyeton studentin për mosdorëzim të punimit. Afati do të jepet më herët. Po qe se do të udhëtoni jashtë vendit, atëherë duhet të dorëzoni punimi më herët. Studenti/ja ka të drejtë të kërkojë konsultim me profesorin sa herë e shih të arsyeshme dhe të nevojshme për kryerjen e punimit të tij/saj. ● Rregullat e mirësjelljes dhe politikat akademike : - o pjesëmarrje aktive e studentëve në ligjërata - o pjesëmarrje në diskutim, komente dhe shprehje e lirë e opinionit, mendimit dhe qëndrimit akademik (me argumente) - o e obligueshme puna e pavarur dhe shfrytëzimi i burimeve shtesë të informacionit (web-faqet e ndryshme shkencore, revista shkencore, përmbledhje punimesh të konferencave etj.) - o respektimi i orareve të ligjëratave pa cenuar lirinë akademike (telefonat celularë pa zë) - o respektimi i fjalës, mendimeve dhe ideve të kolegëve - o tolerancë e ulët ndaj ardhjeve me vonesë dhe daljeve pa ndonjë arsye të qëndrueshme - o përgatitja dhe pajisja me ligjëratat përkatëse, (obligim i mësimdhënësit).
--	--

Mitrovicë

03/01/2022

Bartës/e i/e lëndës:

Ajtene Avdullahi
(Emër Mbiemër)

(Nënshkrimi)